

<b>Njësia akademike:</b>	<b>Orientalistikë</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Tekste shqipe me alfabet arab</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>IV</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+0</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Fakulteti i Filologjisë/ UP Prishtinë</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof. dr. Abdullah hamiti</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="mailto:abdullahamiti@yahoo.com">abdullahamiti@yahoo.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Lënda “Tekste shqipe me alfabet arab” përfshin tekstet e ndryshme shqipe të krijuara me aflatet arab nga fundi i shekullit 17 deri në fillim të shekullit 20. Përqëndrimi bëhet kryesisht në tekstet letrare shqipe të shkruara me alfabet arab duke u njoftuar mirë për rrjedhat e zhvillimin e kësaj pjese të letërsisë shqipe, respektivisht për risitë letrare që këta krijues me alfabet arab i sollën letërsisë së vjetër shqipe. Njëherit studenti do të duhej të ketë njohuri të mjaftueshme edhe për përfaqësuesit më eminent të letërsisë alhamiada shqiptare që përfshihen në këtë cikël e të cilët konsiderohen pararendësit e letërsisë së Rilindjes kombëtare shqiptare dhe të jenë në gjendje që pa vështirësi të veçanta t’i lexojnë tekstet shqipe me alfabet arab.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t’u ofrojë studentëve njohuri për rrjedhën e zhvillimit të letërsisë shqipe me alfabet arab.</li> <li>- të nxënë njohuritë për risitë letrare që këta krijues me alfabet arab i sollën letërsisë së vjetër shqipe.</li> <li>- të ngriten debate dhe diskutime që do të nxisnin mendimin kritik të studentët për vlerat e letërsisë shqipe me alfabet arab.</li> <li>- t’i kuptojnë shkaqet dhe impaktet e letërsisë shqipe me alfabet arab në zhvillimin e letërsisë shqipe në përgjithësi.</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- t’i krahasojë tekstet e ndryshme shqipe me alfabet arab dhe t’i përshkruaj dallimet e tyre grafike.</li> <li>- t’ë diskutojë për ndryshimin stilistik, tematik dhe përmbajtësor të këtyre teksteve.</li> <li>- të diskutojë problemet në leximin/transkriptimin e teksteve shqipe me alfabet arab të cilat sikundër dihet janë në dorëshkrim.</li> <li>- të prezantojë rezultatet e letërsisë shqipe me alfabet arab duke identifikuar përfaqësuesit e saj më eminent.</li> </ul>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithësej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike			
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në teren			
Kollokfiume, seminare			
Detyra të shtëpisë	2	15	30
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	2	1	2
Projektet, prezentimet ,etj	2	1	2
<b>Totali</b>			<b>124</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Mësimi është mësim i rregullt me formën e ligjeratave 2 orë në javë. Do të diskutohen problemet e vështirësitë e leximit/transkriptimit të teksteve që do të zgjedhen nga autorët si: Mulla Dervish Peja, Nezim Frakulla, Muhamed Kyçyk Çami, Tahir Boshnjaku, Sheh Junuzi, H. Ali Ulqinaku, Sheh Mala etj.		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	Do të zbatohen këto metoda të vlerësimit: Vlerësimi i parë: 15% Vlerësimi i dytë: 15% Angazhimet e tjera 15% Vijimi i rregullt 5% Provimi final: 50% Totali 100%		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	Abdullah Hamiti: <b>Nezim Frakulla dhe Divan i tij shqip</b> , Logos – A, 2008, f. 481. Mahmud Hysa, <b>Alamiada shqiptare</b> , “Logos-A”, Shkup, 1997;		
<b>Literatura shtesë:</b>	<b>Poezia e bejtexhinjve</b> , (Përgatiti Hajdar Salihu), “Rilindja”, Prishtinë, 1987; Abdullah Hamiti, <i>Vështirësitë e leximit të teksteve shqipe me grafi arabe</i> , “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, 19, Prishtinë, 2001, f. 143-157.		

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjerata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Rrrethanat politike dhe kulturore para lidnjes së letërsisë shqipe me alfabet arab. Literatura:
<b>Java e dytë:</b>	Fillet e letërsisë shqipe me alfabet arab. Literatura: Mahmud Hysa, <b>Alamiada shqiptare</b> , “Logos-A”, Shkup, 1997; Poezia e bejtexhinjve, (Përgatiti Hajdar Salihu), “Rilindja”, Prishtinë, 1987; Osman Myderrizi, Tekstet e vjetra shqip me alfabetin arab, në:
<b>Java e tretë:</b>	Karakteristikat e letërsisë shqipe me alfabet arab: simbolika, figuracioni... Literatura: Mahmud Hysa, Alamiada shqiptare, “Logos-A”, Shkup, 1997; Poezia e bejtexhinjve, (Përgatiti Hajdar Salihu), “Rilindja”, Prishtinë, 1987; Abdullah Hamiti, Tematika e misticizmit islam në poezinë e bejtexhinjëve, në: Studime Orientale, Nr. 2, Prishtinë, 2002, f. 53-63.
<b>Java e katërt:</b>	Format letrare të letërsisë shqipe me alfabet arab: Mesnevia, Kasidja, Gazelia, Ilahia... Literatura: Abdullah Hamiti, Letërsia shqipe me grafi arabe, në: “Hëna e Re”, Shkup, 1999, Nr. 141; Abdullah Hamiti, Tematika e misticizmit islam në poezinë e bejtexhinjëve, në: Studime Orientale, Nr. 2, Prishtinë, 2002, f. 53-63.
<b>Java e pestë:</b>	Karakteristikat e përbashkëta grafike të autërve të shkrimeve shqipe me alfabet arab -Vështirësitë e leximit të shkrimeve shqipe me alfabet arab. Literatura: Abdullah Hamiti, Vështirësitë e leximit të teksteve shqipe me grafi arabe, “Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”, , 19, Prishtinë, 2001, f. 143-157.
<b>Java e gjashtë:</b>	Vlerësimi i parë intermediar.
<b>Java e shtatë:</b>	Mulla Dervish Peja Literatura: Pjesë të zgjedhura nga vepra “Vasijetname” – lexim.
<b>Java e tetë:</b>	Nezim Frakulla Literatura: Poezi të zgjedhura nga divani shqip i Nezim Frakullës – lexim.
<b>Java e nëntë:</b>	Muhamed Kyçyk Çami Literatura: Pjesë të zgjedhura nga vepra e Çamit – lexim.
<b>Java e dhjetë:</b>	Sheh Junuzi. Literatura: Poezi të zgjedhura nga Divani – lexim
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Tahir Efendi Boshnjaku Literatura: Pjesë të zgjedhura nga vepra “Vehbije” – lexim.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Hafiz Ali Ulqinaku dhe veprat e tij. Literatura: Pjesë të zgjedhura nga veprat në dorëshkrim të Hafiz Ali Ulqinakut –lexim.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Sheh Mala Literatura: Pjesë nga Divani i Sheh Malës – lexim.
<b>Java e katërmëdhjetë:</b>	Mevludet në gjuhën shqipe.

	Literatura: Pjesë të zgjedhura nga tre mevludet në gjuhën shqipe. Mevludi i Konispolit, Hafiz Ali Ulqinakut dhe ai i Tahir Popovës.
<b><i>Java e pesëmbëdhjetë:</i></b>	
Testi provues përfundimtarë	
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:</b>	
<b><i>Cakto politikat e mirësjelljes konfor statusit të UP-së.</i></b>	
Vijimi në ligjërata duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimit duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjiarizmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.	